

ARDIT KULLAFI – ADZM ELBASAN

Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Elbasan (ADZM Elbasan).

Z. Ardit Kullafi ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan, me përgjegjësi në administrimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura, si dhe në ruajtjen e biodiversitetit dhe burimeve natyrore.

Me formim në fushën e pyjeve dhe mjedisit, z. Kullafi është diplomuar në vitin 2012 si Inxhinier Pyjesh dhe ka përfunduar Masterin Shkencor pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Karrierën profesionale e ka ndërtuar në sektorin e pyjeve dhe mjedisit, duke mbajtur pozicione të ndryshme teknike dhe drejtuese pranë strukturave të Bashkisë Librazhd, ndër të cilat Inxhinier Pyjesh dhe Mjedisi, Specialist i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokave Bujqësore, Inspektor i Ujërave dhe Kullimit, si dhe Kryeinspektor i Policisë Pyjore.

Z. Kullafi ka eksperiencë të konsiderueshme në administrimin dhe menaxhimin e pyjeve e kullotave, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, si dhe në përdorimin e teknologjive GIS dhe CAD. Gjatë karrierës së tij ka ndjekur trajnime të ndryshme në fushën e pyjeve, mjedisit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke konsoliduar njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale